



**”Koalicioni i OJQ-ve per Mbrojtjen e Fëmijëve”  
“KOMF”**

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale  
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2023

**PËRMBAJTJA**

**FAQE**

RAPORTI I AUDITORIT

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

1

PASQYRA E TË ARDHURAVE

2

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË GJENDJEN E FONDEVE

3

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

4

SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE

5



## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### Menaxhmentit të “Koalicioni I OJQ-ve per Mbrojtjen e Fëmijëve-KOMF”

#### **Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të “Koalicioni I OJQ-ve per Mbrojtjen e Fëmijëve-KOMF”, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në gjendjen e fondeve dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar në atë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozitën financiar të “Koalicioni I OJQ-ve per Mbrojtjen e Fëmijëve-KOMF” më 31 Dhjetor 2023, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Ligjet aktuale në fuqi.

#### **Baza për Opinion**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

#### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe personave që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me ligjet aktuale në fuqi dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

#### **Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse,

individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritët të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Organizatës.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruarat të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri material ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Armend Osaj – Auditor Ligjor  
ACA – Audit & Consulting Associates  
Prishtinë, Kosovë  
20 Shkurt, 2024




**Koalicioni I OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve-KOMF**  
**Pasqyra e Pozitës Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2023**

<b>PASURITË</b>	<b>Notat</b>	<b>31 Dhjetor 2023 (në EUR)</b>	<b>31 Dhjetor 2022 (në EUR)</b>
<b>Pasuritë qarkulluese</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	<b>3</b>	34,909	81,308
Llogaritë e arkëtueshme	<b>4</b>	-	1,543
Total i pasurive qarkulluese		<u>34,909</u>	<u>82,851</u>
<b>Pasuritë jo-qarkulluese</b>			
Prona dhe pajisjet		-	-
Totali i pasurive jo-qarkulluese		<u>-</u>	<u>-</u>
<b>TOTALI I PASURISË</b>		<u><b>34,909</b></u>	<u><b>82,851</b></u>
<b>DETYRIMET DHE REZERVAT</b>			
<b>Detyrimet rrjedhëse</b>			
Llogaritë e pagueshme dhe shpenzimet akruale	<b>5</b>	-	3,346
Të hyrat e shtyera	<b>6</b>	34,909	79,505
Totali i detyrimeve rrjedhëse		<u>34,909</u>	<u>82,851</u>
<b>FONDET</b>			
Bilanci i fondeve		-	-
Totali fondeve		<u>-</u>	<u>-</u>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE REZERVAVE</b>		<u><b>34,909</b></u>	<u><b>82,851</b></u>

Pasqyrat financiare janë nënshkruar me 20 Shkurt 2024 nga:

**Donjetë Kelmendi**



Drejtor Ekzekutiv

**Mersije Krasniqi**



Menaxhere e Financës dhe Administratës

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 11 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

**Koalicioni I OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve-KOMF**  
**Pasqyra e të ardhurave**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2023**

---

	Notat	31 Dhjetor 2023 (në EUR)	31 Dhjetor 2022 (në EUR)
<b>Të Hyrat</b>			
Të Hyrat nga donatorët	7	272,975	183,688
<b>Të Hyrat totale</b>		<b>272,975</b>	<b>183,688</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Burimet Njerëzore	8	88,620	71,953
Shpenzime administrative	8	15,023	10,908
Shpenzimet e projektit	9	164,877	79,387
Shpenzimet e projektit-dhënie e granteve	10	4,454	21,441
<b>Shpenzimet totale</b>		<b>272,975</b>	<b>183,688</b>
<b>Neto (Deficit)/Suficit për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 11 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

**Koalicioni I OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijeve-KOMF**  
**Pasqyra e ndryshimeve në gjendjen e fondeve**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2023**

---

	<b>Total</b> <b>(në EUR)</b>
<b>Bilanci fillestar më 01 janar 2022</b>	-
Fitimi/ (Humbja) neto për vitin	-
<b>Bilanci përfundimtar më 31 dhjetor 2022</b>	-
<b>Bilanci fillestar më 01 janar 2023</b>	-
Fitimi/ (Humbja) neto për vitin	-
<b>Bilanci përfundimtar më 31 dhjetor 2023</b>	-

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 11 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

**Koalicioni I OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve-KOMF**  
**Pasqyra e rrjedhës së parasë**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2023**

---

	<b>31 Dhjetor 2023 (in EUR)</b>	<b>31 Dhjetor 2022 (in EUR)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Deficiti)/Mbetja për periudhën	-	-
Rregulluar për:	-	-
Zhvlerësimi	-	-
Ndryshimi në të arkëtueshmet	1,543	15,643
Ndryshimi në të hyrat e shtyra	(44,596)	(53,451)
Ndryshimi në të pagueshmet	(3,346)	2,485
<b>Paraja neto nga aktivitetet operative</b>	<b>(46,399)</b>	<b>(35,323)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Blerja e pronave dhe pajisjeve	-	-
<b>Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>	<b>(46,399)</b>	<b>(35,323)</b>
Paraja dhe ekuivalentet e saj më 1 janar	81,308	116,631
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj më 31 dhjetor</b>	<b>34,909</b>	<b>81,308</b>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 11 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare



# **Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve=KOMF**

## **Shënimet e Pasqyrave Financiare**

### **Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2023**

---

#### **1. HYRJE**

**Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF**, i themeluar në Qershor të vitit 2011, është një koalicion i përbërë nga 35 organizata jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, me mision të përbashkët avokimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Misioni i Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve është mbrojtja, respektimi, mirëqenia dhe avancimi i të drejtave të drejtave të fëmijëve.

Kjo realizohet nëpërmjet lobimit dhe avokimit për promovimin dhe zhvillimin e të drejtave të fëmijëve sipas KDF-së.

KOMF në mënyrë të vazhdueshme, pranon kërkesa të reja nga organizata të ndryshme në Kosovë për anëtarësim.

Objektivat kryesore të Koalicionit janë:

- Nxitja e miratimit të ligjeve dhe politikave për fëmijët.
- Monitorimi i zbatimit të ligjeve dhe politikave kombëtare për fëmijët.
- Sensibilizimi dhe mobilizimi i autoriteteve shtetërore relevante në nivel lokal dhe nacional, sensibilizimi i ofruesëve të shërbimeve dhe i aktorëve të tjerë në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.
- Rritja e vetëdijesimit tek opinioni i gjerë për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve pa dallim.
- Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të gjitha grupeve që janë më të ekspozuara ndaj shkeljes së të drejtave të fëmijëve.
- Krijimi i hapësirave për zhvillimin e praktikave më të mira, në fushën e të drejtave të fëmijëve, dokumentimi dhe ndarja me të gjithë anëtarët e koalicionit.
- Fuqizimi i kapaciteteve të koalicionit, veçanërisht fuqizimi i organizatave lokale dhe organizatave të bazuara në komunitet.

**Koalicioni I OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve=KOMF**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2023**

---

**2. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL**

**2.1 Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare për Organizatën janë përgatitur në bazë të kontabilitetit në bazë të keshit për të hyrat dhe shpenzimet. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë.

**2.2 Valuta e përdorur**

Valuta funksionale e Organizatës është valuta e Bashkimit Evropian Euro (“EUR”). Pasqyrat financiare janë prezantuar në euro.

**2.3 Shkëmbimi i valutës së huaj**

Organizata nuk kryen transaksione në valuta të huaja

**2.4 Paraja dhe ekuivalentet e parasë**

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë janë konsideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse, si dhe paraja me maturitet jo më shumë se tre muaj.

**2.5 Tatimet**

Organizata u themelua si një organizatë joqeveritare, për këtë arsye ka përgjegjësi dhe vepron si një OJQ sipas ligjeve në fuqi të Kosovës.

**2.6 Shpenzimet**

Shpenzimet e ndodhura janë njohur në periudhën përkatëse në baza të keshit.

**2.7 Njohja e të hyrave**

Të hyrat nga grantet njihen si të ardhura në periudhën kur paguhen. Në fund të vitit sasia e tepërt e të ardhurave krahas shpenzimeve trajtohen si bilanc i bartur në periudhën e ardhshme.

**2.8 Përfitimet e të punësuarve**

Organizata, në rrjedhën normale të biznesit, bën pagesa në buxhetin e shtetit për llogari të puntorëve. Puntorët e Organizatës janë anëtarë të planit shtetëror të pensioneve. Të gjitha kontributet e tilla në skemat e pensioneve të detyrueshme qeveritare shpenzohen kur ato ndodhin. Organizata nuk operon asnjë skemë tjetër pensioni ose plan përfitimesh pas daljes në pension dhe, rrjedhimisht, nuk ka asnjë detyrim në lidhje me pensionet.

## Koalicioni I OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve=KOMF

### Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2023

---

#### 3. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

	31 Dhjetor 2023 (në EUR)	31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Paraja në bankë	34,846	81,308
Pajraja në arkë	63	-
<b>Totali i parasë dhe ekuivalentëve e parasë</b>	<b>34,909</b>	<b>81,308</b>

#### 4. LLOGARITË E ARKËTUESHME

	31 Dhjetor 2023 (në EUR)	31 Dhjetor 2022 (në EUR)
SUSWELL	-	1,261
OFAP 02	-	200
Tjera	-	82
<b>Totali i llogarive të arkëtueshme</b>	<b>-</b>	<b>1,543</b>

#### 5. LLOGARITË E PAGUSHME DHE SHPENZIMET AKRUALE

	31 Dhjetor 2023 (në EUR)	31 Dhjetor 2022 (në EUR)
KMOP	-	1,196
Tatimi në paga dhe kontributet	-	2,141
Të pagueshmet tjera	-	9
<b>Totali i llogarive të pagueshme dhe shpenzimet e akruale</b>	<b>-</b>	<b>3,346</b>

**Koalicioni I OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve=KOMF**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2023**

**6. TË HYRAT E SHTYERA**

	<b>31 Dhjetor 2023 (in EUR)</b>	<b>31 Dhjetor 2022 (in EUR)</b>
KOMF - Kostot indirekte	19,967	4,652
SMART Balkans	9,652	-
UNICEF_1	2,890	-
Kuvendi I KOMF-it	2,400	1,450
UNICEF	-	23,258
EU	-	28,353
KCSF_EJA	-	21,793
<b>Totali i të hyrave të shtyera</b>	<b>34,909</b>	<b>79,505</b>

**7. TË HYRAT**

	<b>31 Dhjetor 2023 (në EUR)</b>	<b>31 Dhjetor 2022 (në EUR)</b>
Të Hyrat nga Donatorët	272,975	183,688
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>272,975</b>	<b>183,688</b>

**8. BURIMET NJERËZORE DHE SHPENZIMET ADMINISTRATIVE**

	<b>31 Dhjetor 2023 (në EUR)</b>	<b>31 Dhjetor 2022 (në EUR)</b>
Shpenimet për burime njerëzore	88,620	71,953
Shpenzime e qirasë	5,320	5,160
Shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve	2,423	2,045
Shpenzimet për shërbimet komunale	2,410	1,955
Shpenzimet për furnizim të zyrës	2,324	1,212
Shpenzimet e komunikimit	1,285	536
Shpenzimet për pagat e stafit	1,261	-
<b>Totali i burimeve njerëzore dhe shpenzimet administrative</b>	<b>103,643</b>	<b>82,861</b>

**Koalicioni I OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve=KOMF**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2023**

**9. SHPENZIMET E PROJEKTIT**

	<b>31 Dhjetor 2023 (në EUR)</b>	<b>31 Dhjetor 2022 (në EUR)</b>
Shërbimi catering/drekë	21,209	17,174
Të tjera	19,864	2,353
Angazhimi i shërbimeve sociale	16,200	-
Transmetimi në kombëtaren kryesore	15,664	-
Trajnimi	11,994	6,907
Ekspertët dhe trajnerët	10,371	8,500
Prodhimi i rritjes së ndërgjegjësimit	10,099	-
Përkthimi	7,446	-
Vendi, dreka dhe pije freskuese	7,361	7,038
Takime/workshope të ndryshme	6,259	-
Verifikimi i shpenzimeve-Auditim	6,000	-
Ekspert vendas	4,920	1,403
Vlerësimi	4,123	-
Vizitë studimore	4,076	13,720
Çmimet vjetore për masën më të mirë	4,010	4,500
Dizajn dhe printim	2,698	2,553
Transport për 7 anëtarë të projektit	2,158	80
Zhvillimi i promovimit	2,158	1,997
Salla/ambjentet e konferencave	1,730	3,659
Tarifa	1,650	42
Karrige për sallën e mbledhjeve të KOMF	1,479	720
Shpenzimet e udhëtimit	1,255	1,170
TV për sallën e mbledhjeve KOMF	1,236	580
Shërbimet financiare (garanci bankare)	771	653
Kostoja e qëndrimit	105	983
Kostot indirekte të KOMF	42	1,380
Prokurimi për promovim e televizorëve	-	3,214
Kompjuter PC për nevojat e projektit	-	760
<b>Totali i shpenzimeve të projektit</b>	<b>164,877</b>	<b>79,387</b>

**Koalicioni I OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve=KOMF**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2023**

---

**10. SHPENZIMET E PROJEKTIT – DHËNIA E GRANTEVE**

	<b>31 Dhjetor 2023 (në EUR)</b>	<b>31 Dhjetor 2022 (në EUR)</b>
OFAP	4,454	9,696
SOS Fshatrat e Femijeve	-	6,279
KMOP	-	5,466
<b>Totali i shpenzimeve të projektit-dhënie e granteve</b>	<b>4,454</b>	<b>21,441</b>

**11. NGJARJET PASUESE**

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim ose shpalosje në pasqyrat financiare.